



Nehemiah Gateway Albania Foundation
Rr. "Nehemia"
7304 Buçimas, Albania

T +355 83 600 404
F +355 83 600 405
office-al@nehemiah-gateway.org
www.nehemiah-gateway.al

NIPT J64103684E
Procredit Bank
SWIFT FEFAALTRXXX
IBAN AL03209425530000550024220002

Prot Nr.:654/18

BORDI MBIKËQYRËS

(Senati Akademik)

Vendimi Nr. 256, datë 24.11.2018

Bordi Mbiqëqyrës i Shkollës së Lartë "Nehemiah Gateway", në funksionin e tij si Senat Akademik, në takimin datë 24.11.2018, vendosi të miratojë kriteret e pranimit të studentëve në programet e ciklit të parë dhe të dytë për vitin akademik 2019-2020 sipas propozimit të marrë nga Departamenti i Biznesit (i cili ofron programet e ciklit të parë) dhe Departamenti i Edukimit (i cili ofron programet e ciklit të dytë) të Fakultetit të Biznesit dhe atë të Edukimit si më poshtë:

Kriteret e pranimit për programin e studimit të ciklit të parë në "Biznes dhe Ekonomi" janë si më poshtë:

1. Nota mesatare e maturës: jo më e ulët se 7
2. Njohuri të gjuhës angleze: jo më pak se nivelin B1 (e certifikuar)
3. Nota mesatare e matematikës: jo më e ulët se 7
4. Të marrin pjesë në konkursin e pranimit

Renditja e kandidatëve bëhet bazuar në formulën:

25 % - Nota mesatare e maturës

20% - Nota mesatare e maturës në lëndën matematikës

25% - Nota mesatare e maturës në lëndën gjuhës angleze

30% - Intervista në gjuhën angleze

Kriteret e pranimit për programin e studimit të ciklit të dytë në "Leadership dhe Vlerësim Arsimit", janë si më poshtë:

1. Nota mesatare gjatë studimeve Bachelor: jo më e ulët se 7

2. Njohuri të gjuhës angleze: jo më pak se nivelin B2 (e certifikuar), bazuar në udhezimet Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë
3. Të marrin pjesë në konkursin e pranimit (intervistë)

Renditja e kandidatëve bëhet bazuar në formulën: 100% intervista.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

Kryetari / Bordit Mbikëqyrës


Arnold Geiger

NEHEMIAH GATEWAY
ALBANIA

Fondacion
Rr. Nehemia - 7304 Buçimas



Matura Shtetërore 2020

@matura.shteterore